



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 280/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/05/2018 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomik “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime” me objekt “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, për vitin 2018” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.” me nr. REF-41179-01-19-2018, me fond limit 2.916.569 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shtiqni” shpk. dhe vendimin mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk. si edhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Nazeri 2000” sh.p.k.

*Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra “Condor” kati II
Tiranë*

“Shtiqni” sh.p.k.

*Adresa: Lagjia Nr.4 Pallati 8 ap 3
Kukës*

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has

*Adresa: Rruga e Spitalit, Lagjia Nr 2,
Krumë*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Public Health Sector

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.01.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *Kërkesë për propozime* me objekt *“Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, për vitin 2018” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.* me nr. REF-41179-01-19-2018, me fond limit 2.916.569 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.

II.2. Në datën 02.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 09.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Shtiqni” shpk	1604.51 lekë	skualifikuar
2. “Eurogjici Security” shpk	7988.20 lekë	skualifikuar;
3. “Trezhnjeva” shpk	7988.96 lekë	kualifikuar
4. “Nazeri 2000” shpk	7990.45 lekë	kualifikuar
5. “Sabeta” shpk	585646.15 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 15.02.2018, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “Trezhnjeva” shpk, “si edhe shtimin e arsyeve të

skualifikimit të operatorëve ekonomik “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: “[...]

- i. Së pari, nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” shpk pasi nuk kanë parashikuar pagën minimale në bazë të VKM nr. 399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2017 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” e cila duhej përllogaritur në vlerën $36000:30.41=1183.82$ lekë.
- ii. Së dyti nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” shpk pasi nuk ka parashikuar shtesat mbi pagë për turnin e II për një roje në përputhje me nenin 81 të kodit të Punës të cialt duhej të përllogarteshin në vlerën $206.89 \text{ lekë/ora} \times 3 \text{ orë} \times 20 \% = 124.134:4.98 = 24.92 \text{ lekë/dita}$ për një roje.
- iii. Së treti nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” shpk pasi nuk ka parashikuar “Shtesën mbi pagë për turnin III” për një roje në përputhje me nenin 81 të Kodit të Punës të cilat duhej të përlloagriteshin në vlerën $206.89 \text{ lekë/ora} \times 8 \text{ orë} \times 50 \% = 827.56:4.98 \text{ roje} = 166.17 \text{ lekë/dita}$ shtesa turni i tretë.
- iv. Nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” shpk pasi nuk ka parashikuar saktë “Shpenzime për sigurime shoqërore & Shëndetësore në masën 16.7 % për një roje.
- v. Së dyti nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” pasi nuk kanë paraqitur analizë kosto sipas kërkesës së dhënë në dst shtojca 6 pika 6 “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e koston për ofertën e paraqitur (Shih Shtojca 1-Sqarime.
- vi. Së treti nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për “Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 5 punonjës shërbimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Qarkut Kukës. Vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave-datën e certifikimit (datën e lëshimit) si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate. Ky vërtetim të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga datia e hapjes së ofertave. Këto shoqëri nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për certifikata të vlefshme brenda afatit 4

vjeçar sipas ligjit nr.75/2014 neni 5 pika 5 për numrin e kërkuar nga AK. Si dhe nuk kanë paraqitur vërtetim brenda afatit të kërkuar.

- vii. Së katërti ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” pasi nuk plotëson kërkesën shtojca 7 ku AK ka kërkuar “Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit të ketë një vlerë sa vlera e fondit të Marrëveshjes Kuadër. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit.” Këto shoqëri nuk kanë paraqitur vërtetim për xhiro për vitin 2017. [...]”

II.4.2. Në datën 19.02.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.134/1 prot datë 19.02.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk.

II.4.3. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi inspektori dokumentet e paraqitura në sistem nga operatorët ekonomik “Trezhnjeva” shpk “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk, objekt ankese rezulton si më poshtë: Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk se : Nga ana e autoritetit duhet të skualifikohet shoqëria “Trezhnjeva” shpk dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për “Shtiqni” shpk, “Eurogjici Security” shpk pasi nuk kanë parashikuar pagën minimale në bazë të VKM nr. 399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2017 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe nuk kanë parashikuar saktë shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi kontrollon analizën e kostos, konstaton se përlllogaritja e pagës bazë, shtesat për pagë turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për një rojenë ditë dhe rrjedhimisht edhe për një vendorje me tre trune në ditë nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” shpk është bërë në përputhje me VKM-në nr.399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2017 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe VKM-së nr.114 datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” pra nuk është nën kufirin minimal ligjor të lejuar. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.... Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Trezhnjeva” shpk, “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk rezulton që në përmbushje të këtij kriteri këto operatorë ekonomikë kanë paraqitur analizën e kostos. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Trezhnjeva” shpk, “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk rezulton që në përmbushje të këtij kriteri këto operatorë ekonomikë kanë paraqitur vërtetimet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.... Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Trezhnjeva” shpk, “Shtiqni” shpk dhe “Eurogjici Security” shpk rezulton që në përmbushje të këtij kriteri këto operatorë ekonomikë kanë

paraqitur vërtetimet e xhiros për vitin 2017 në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. [...]”

II.4.4. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Operatori ekonomik “Shtiqni” shpk është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se *“Autoriteti kontraktor në DST, shtojca nr 1 Formulari i Ofertes Ekonomike ka kërkuar nga operatorët ekonomik që të deklarojnë ofertën e tyre për Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorise se Shërbimit Spitalor Has, për 1 vend roje me 3 turne në dite, e cila në bazë të analizës së kostos së paraqitur nga operatori ekonomik Shtiqni shpk është 7990,45 leke pa TVSH. Operatori ekonomik Shtiqni shpk në formularin e ofertes ka deklaruar çmimin e ofertës 1604,51 leke pa TVSH. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik Shtiqni shpk, formularin e ofertës ekonomike e ka plotësuar në kundërshtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktor (Shtojca 1 Formulari i Ofertes Ekonomike, sqarime pika 1)”*

II.5.1. Në datën 15.02.2018, operatori ekonomik ankimues “Shtiqni” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk si dhe mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk.

II.5.2. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: *“[...] Pasi u njohëm me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës si dhe me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë këtij autoriteti kontraktor mbi skualifikimin e OE SHPSF “Shtiqni” shpk me pretendimin se nuk është paraqitur Formulari i Ofertës siç është kërkuar në DST pasi nuk është plotësuar oferta në mënyrë të rregullt pasi në ofertën tonë kemi paraqitur shpenzimet për një roje dhe jo për një ditë shërbimi me pretendimin se është në kundërshtim me Formularin e Ofertës të kërkuar nga AK në DST gjë e cila nuk është specifikuar në kushtet për kualifikim por është shprehur të formulari i Ofertës sipas shtojcës 1 të vendosur në DST. Nga ana e Njesisë së Prokurimit është kërkuar Formulari i Ofertës (i kërkuar sipas Shtojcës 1 të vendosur në DST) dhe nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë nëse në ofertë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin çmimin total të ofertës për shërbim 24 orësh të kërkuar apo për çmimin total të ofertës për një roje shërbimi dhe në kushtet e veçanta për kualifikim por është kërkuar Formulari 1 i Ofertës sipas shtojcës nr.1 të vendosur në DST) dhe nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë nëse në ofertë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin çmimin total të ofertës për shërbimin 24*

orësh të kërkuar apo për çmimin total të ofertës për një roje shërbimi dhe në kushtet e veçanta për kualifikim por është kërkuar Formulari 1 i Ofertës ekonomike.... Po të shikohet me vëmendje në rubrikat që përmban ky formular nuk ka të përcaktuar në mënyrë të saktë nëse oferta duhet të përllogaritet për shërbimin e kërkuar për një roje shërbimi në ditë apo në një ditë shërbimi çka bën që oferta jonë të jetë e saktë dhe pa cënuar çmimin e ofertës pasi dhe nga ana e KVO-së në argumentimin e bërë në lidhje me arsyet e skualifikimit të OE “SHPSF Shtiqni” shpk e kanë shprehur se në analizën e kostos si edhe shërbimin e kërkuar për një roje në ditë çka bën që oferta jonë është e vlefshme dhe e saktë. Në rastin konkret jemi përballë nenit 53 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 të ndryshuar të prokurimeve publike pasi ky nen shprehet si më poshtë: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj” Pra na ana e komisionit të vlerësimit të ofertave pranë Ak nuk është zbatuar ky nen pasi oferta e paraqitur nga ana jonë nuk ka për qëllim që me anë të saj të kualifikohemi me mashtrim me ligjin por mund të quhen vijime të vogla të realizuara nga ana jonë pasi në kushtet për kualifikim nuk është përcaktuar që oferta duhet të paraqitet për shpenzime ditore dhe jo për një roje në ditë pasi devijimi i realizuar është i argumentuar nga ana jonë me anë të Analizës së kostos ku janë pasqyruar dhe shpenzimi ditor me shërbim 24 orësh për tre turne si dhe shpenzime për një roje shërbimi në ditë çka e bën ofertën tonë të vlefshme dhe nuk mund të skualifikohemi në këtë procedurë prokurimi. Nga ana Komisionit të Ofertave është realizuar vlerësimi i ofertave dhe rezulton se më të drejtë është skualifikuar OE “Eurogjici Security” pasi oferta e paraqitur nga ana e tij është nën koston ligjore të lejuar por nga ana jonë konstatohet se dhe OE “Trezhnjeva” shpk duhet të skualifikohet pasi dhe oferta e tij rezulton të jetë nën koston ligjore të lejuar pasi ka ulur ofertën në mashtrim me ligjin për qëllime kualifikimi dhe renditje në vend të parë me qëllim fitimin e kësaj procedure prokurimi[....]”

II.5.3. Në datën 19.02.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.131/1 prot datë 19.02.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Shtiqni” shpk.

II.5.4. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton që në përmbushje të këtij kriteri, ofertuesi ka paraqitur formularin e ofertës ku ka deklaruar çmimin e ofertës për një roje në ditë 1604.51 lekë pa TVSH dhe 1925 leke më TVSH. Në dokumentet standarde të tenderit (DST) shtocja 1 formulari i ofertës ekonomike, sqarime pika 1 është kërkuar që “në çmimin të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend roje me tre turne” Pra në formularin e ofertës ekonomike duhej të deklarohet çmimin total të ofertës ditore për 1 vend roje me 3 turne e barabartë me 4.98 roje. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës bazuar në analizën e mësipërme gjykon se operatori ekonomik

“Shtiqni” shpk, formularin e ofertës ekonomike e ka plotësuar në kundërshtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktor (shtojca 1 Formulari i Ofertës Ekonomike, sqarime pika 1) Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimeus nuk qëndron. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi kontrolli analizën e kostos, konstatoj se përllogaritja e pagës bazë, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për një roje në ditë dhe rrjedhimisht edhe për një vend roje me tre turne në ditë nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” shpk është bërë në përputhje me VKM-në nr.399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, në ligjin nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe VKM-së nr.114 datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, pra nuk është nën kufirin minimal ligjor të lejuar. Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimeus nuk qëndron. [...]”

II.6. Në datën 07.03.2018 me anë të shkresës nr. 131/5 prot datë 06.03.2018, dhe nr. 134/3 prot datë 06.03.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.



III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Shtiqni” shpk për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *“[...] Pasi u njohëm me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës si dhe me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë këtij autoriteti kontraktor mbi skualifikimin e OE SHPSF “Shtiqni” shpk me pretendimin se nuk është paraqitur Formulari i Ofertës siç është kërkuar në DST pasi nuk është plotësuar oferta në mënyrë të rregullt pasi në ofertën tonë kemi paraqitur shpenzimet për një roje dhe jo për një ditë shërbimi me pretendimin se është në kundërshtim me Formularin e Ofertës të kërkuar nga AK në DST gjë e cila nuk është specifikuar në kushtet për kualifikim por është shprehur të formulari i Ofertës sipas shtojcës 1 të vendosur në DST. Nga ana e Njesisë së Prokurimit është kërkuar Formulari i Ofertës (i kërkuar sipas Shtojcës 1 të vendosur në DST) dhe nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë nëse në ofertë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin çmimin total të ofertës për shërbim 24 orësh të kërkuar apo për çmimin total të ofertës për një roje shërbimi dhe në kushtet e veçanta për kualifikim por është kërkuar Formulari 1 i Ofertës sipas shtojcës nr.1 të vendosur në DST) dhe nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë*

nëse në ofertë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin çmimin total të ofertës për shërbimin 24 orësh të kërkuar apo për çmimin total të ofertës për një roje shërbimi dhe në kushtet e veçanta për kualifikim por është kërkuar Formulari 1 i Ofertës ekonomike.... Po të shikohet me vëmendje në rubrikat që përmban ky formular nuk ka të përcaktuar në mënyrë të saktë nëse oferta duhet të përlligjaritet për shërbimin e kërkuar për një roje shërbimi në ditë apo në një ditë shërbimi çka bën që oferta jonë të jetë e saktë dhe pa cënua çmimin e ofertës pasi dhe nga ana e KVO-së në argumentimin e bërë në lidhje me arsyet e skualifikimit të OE “SHPSF Shtiqni” shpk e kanë shprehur se në analizën e kostos si edhe shërbimin e kërkuar për një roje në ditë çka bën që oferta jonë është e vlefshme dhe e saktë. Në rastin konkret jemi përballë nenit 53 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 të ndryshuar të prokurimeve publike pasi ky nen shprehet si më poshtë: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj” Pra na ana e komisionit të vlerësimit të ofertave pranë Ak nuk është zbatuar ky nen pasi oferta e paraqitur nga ana jonë nuk për qëllim që me anë të saj të kualifikohemi me mashtrim me ligjin por mund të quhen vijime të vogla të realizuara nga ana jonë pasi në kushtet për kualifikim nuk është përcaktuar që oferta duhet të paraqitet për shpenzime ditore dhe jo për një roje në ditë pasi devijimi i realizuar është i argumentuar nga ana jonë me anë të Analizës së kostos ku janë pasqyruar dhe shpenzimi ditor me shërbim 24 orësh për tre turne si dhe shpenzime për një roje shërbimi në ditë çka e bën ofertën tonë të vlefshme dhe nuk mund të skualifikohemi në këtë procedurë prokurimi” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogaritur ne dite
1.	Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, per 1 vend roje me 3 turne	dite	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				

	Çmimi Total
--	--------------------

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operatores janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha koston per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vëndroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).

- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)
- Llogaritja e zerave te mos kaloje dy shifra pas presjes dhjetore.

III.1.2. Në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë, seksioni II, "Përlllogaritja e ofertës" është parashikuar: "Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen, sasi të dhe çmimin e tyre. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës. 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës. 2.4. Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër."

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

III.1.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....".

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Formularit të Ofertës dhe analizën e kostos nga ana e operatorit ekonomik "Shtiqni" shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik "Shtiqni" shpk është deklaruar se çmimi total i ofertës për një roje në ditë është 1604.51 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së si edhe çmimi total i ofertës për një roje në ditë është 1924.41 lekë duke përfshirë vlerën e TVSH-së. Gjithashtu, referuar analizës së kostos së dorëzuar KPP konstaton se nga ana e operatorit ekonomik vlera prej 1,604.51 lekë është përlllogaritur si vlerë për kryerjen e shërbimit për një roje dhe jo për një vendroje në ditë. Gjithashtu KPP konstaton se operatori ekonomik ankimes ka ndryshuar përmbajtjen e Formularit të Ofertës duke shtuar se çmimi total i ofertës (me dhe pa TVSH) është për një roje në ditë. Ndërkohë, KPP gjykon se autoriteti

kontraktor,në dokumentet e procedurës së prokurimit ka sqaruar ndër të tjera se oferta e operatorëve ekonomikë duhet të dorëzohet për një vendroje me tre turne në përputhje me termat e kryerjes së shërbimit dhe jo si vlera totale e çmimit të kërkuar për një roje-punonjës shërbimi. Konkretisht në formularin e ofertës autoriteti kontraktor ka përcaktuar edhe shërbimin për të cilën do të ofertohet ku ka sqaruar se *Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorise se Shërbimit Spitalor Has, per 1 vend roje me 3 turne.* Gjithashtu në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë, seksioni II, *"Përlllogaritja e ofertës"* është parashikuar: *"Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen, sasi të dhe çmimin e tyre. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.*2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.2.4. Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimit midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër." Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumenteve të tenderit do të refuzohet. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka parashikuar dorëzimin e ofertës në total për kryerjen e shërbimit për një ditë për vendroje dhe jo për një roje-punonjës shërbimi, fakt ky i pranuar edhe vetë nga ankimuesi referuar parashtrimeve me shkrim pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.6. Gjithashtu, KPP gjykon se nuk ndodhemi as para rastit të parashikuar nga neni 53 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar ku parashikohet se *"Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj."* Në rastin konkret, korrigjimi i propozuar ndryshon në tërësi ofertën dhe vlerën totale të ofertës ekonomike të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues.

III.1.7. Në rast se operatori ekonomik "Shtiqni" shpk do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për*

Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shtiqni” shpk për skualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomik me pretendimin se oferta e tyre është nën koston ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Shtiqni” shpk mbetet e skualifikuar operatori ekonomik ankimues nuk ka tashmë asnjë interes të ligjshëm e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Treznjeva” shpk me pretendimin se është nën minimumin ligjor të lejuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.3.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai,

përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.3.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.3.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetin kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.3.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij

shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkojë të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç

edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.3.8. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet si më poshtë:

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogaritit r ne dite
1.	Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorise se Sherbimit Spitalor Has, per 1 vend roje me 3 turne	dite	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime:

3. Ne cmim te jene te perfshira te qjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri liqor ne lidhje me paqat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.

4. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analizë e koston

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë		

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).**
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit)
- Llogaritja e zerave të mos kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

III.3.9. Në shtojcën 10 "Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shërbimi që kërkohet:

Objekti: "Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, për vitin 2018" – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj

Vendndodhja e shërbimit: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has, Lagjia Nr 2, Qyteti Krume

Numri i Numri i turneve Numri i rojeve Afati i levrimit

Vendrojeve te nevojshme

1 3 4.98 12 muaj

Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.3.10.. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përllogarisin pagën bazë minimale ligjore në vlerën prej 36.000 lekë, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesi, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës së operatorëve ekonomik “Trezhnjeva” shpk dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) –elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ofertën ekonomike të paraqitura nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. reuizlon se ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me pagën minimale shtesat mbi trunin e dytë dhe të tretë edhe rrjedhimisht edhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, nga oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik “Trezhnjeva” shpk shqyrtohet plotësimi i elementëve bazë të ofertës sipas zërave të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk për shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, dhe “Shtiqni” shpk Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Shtiqni” shpk mbetet e skualifikuar referuar vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me

operatorin ekonomik “Shtiqni” shpk, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka tashmë asnjë interes të ligjshëm nga ankimuesi e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomik të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.4.1. Në ankesën drejtuar pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. nuk parashtron fakte . ngren pretendime *a-priori* për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar duke ngritur pretendime se nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit, parashikuar në dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.4.2 Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010, *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:*

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.4.3. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrative, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.*

III.4.4. Operatori ekonomik e ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.4.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.4.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.4.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cila thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për rrjedhojë pretendimet e ankimuesit nuk merren shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorëve ekonomik “Nazeri 2000” shpk “Shtiqni” shpk dhe për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozime*” me objekt “*Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të objekteve dhe godinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Has, për vitin 2018*” – *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.*” me nr. REF-41179-01-19-2018, me fond limit 2.916.569 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 337 Protokolli; Datë 23.02.2017;

Nr. 361 Protokolli; Datë 26.02.2017;

